



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 56/09**

**Prishtinë, më 15.07.2009, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik dhe Armend Zemaj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani, Hajdin Abazi dhe Riza Smaka.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Mehdi Geci nga KPMK-ja, Teki Shala nga NDI , monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 22.06.2009;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008, I ftuar : Mehdi Geci, Kryetar i KPMK-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë, nr. 2003/17;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazin Natyror me raportin e komisionit funksional Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;**
- 8. Të ndryshme.**

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 22.06.2009**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 22.06.2009, miratohet pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Raportit Financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008**

**Kryesuesi**, theksoi se raporti financiar i KPMK-së për vitin 2008 është i mangët dhe i njëjti nuk i plotëson kushtet ligjore të raportimit financiar. Prandaj propozoi që raporti të mos miratohet dhe i njëjti të plotësohet në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë dhe formularëve të MEF-ti që janë standarde për të gjitha organizatat buxhetore që përfitojnë nga fondet publike dhe që i raportojnë Kuvendit.

**Safete Hadërgjonaj**, vlerësoi raportin financiar shumë të mangët, në të cilin nuk janë prezantuar të dhëna të mjaftueshme. Kërkoj që Komisioni me një rekomandim, të kërkojë plotësimin e tij me pjesën financiare dhe deri në këtë kohë materiali mos të dërgohet në Kuvend. Raporti të plotësohet në bazë të formularëve standard të MEF-it.

**Armend Zemaj**, gjithashtu vlerësoi raportin të mangët dhe propozoi që Këshillit t'i jepet një javë kohë për plotësimin e tij në bazë të formularëve standard të MEF-it, në të cilin do të duhej të jepeshin të dhëna më të detalizuara për shpenzimin e mjeteve financiare në vitin 2008.

**Myrvete Pantina**, për shkak të mungesës së pjesës financiare, gjithashtu u pajtua që Këshillit t'i jepet një afat prej shtatë ditësh, për plotësimin e raportit me pjesën financiare të tij.

**Kosara Nikolić**, theksoi se raporti nuk është i kompletuar dhe u pajtua me propozimet, që Këshilli brenda shtatë ditësh të plotësojë raportin me pjesën financiare, me të dhëna më të detalizuara dhe i njëjti të dërgohet për shqyrtim në komision.

**Mehdi Geci**, u pajtua me vërejtjet e anëtarëve të komisionit për mangësitë e raportit në pjesën financiare, dhe premtoi do të bëjnë plotësimin e tij dhe mëpastaj të dërgojnë për shqyrtim në Kuvend.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

- I. Raporti financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008, shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit dhe i njëjti duhet të plotësohet në bazë të formularëve standard të MEF-it.

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë, nr. 2003/17**

**Kryesuesi**, propozoi që projektligji të analizohet nen për nen, dhe eventualisht të bëhen ndryshimet e nevojshme të tij në formë të amendamenteve, në mënyrë që të procedohet në procedurë të metutjeshme për miratim në Kuvend. Njoftoi se nga Divizioni i Kuvendit për Standardizim dhe Harmonizim Ligjor kemi të propozuar dy amendamente dhe kërkoj që të mbështeten ato.

Në vazhdim anëtarët shqyrtuar projektligjin duke disa ndryshime. U ndryshua titulli i projektligjit, neni 1, neni 2 që i referohet nenit 4. të LPP, neni 3 që i referohet nenit 24.5 si dhe neni 5 që i referohet nenit 34.23. Këto ndryshime u mbështetën nga shumica e anëtarëve dhe të njëjtat do të prezantohen në formë të amendamenteve në raportin e komisionin, në procedurën e mëtutjeshme për miratim në Kuvend.

**Haki Shatri**, kërkoi që nenin 5, paragrafi 34.17 të ndryshohet, përndryshe theksoi se nuk e përkrah ashtu siç është shkruar në projektligj.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me shtatë vota Për, një Kundër (z. Haki Shatri,) asnjë Abstenim, Komisioni nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Miratohen amendamentet për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë, nr. 2003/17
- II. Raporti me amendamente procedohet në procedurë të mëtutjeshme për miratim në Kuvend.

#### **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale**

**Kosara Nikolić**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për miratimin në parim të Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, në të cilin Komisioni për Buxhet dhe Financa është komision funksional.

Anëtarët e pranishëm të komisionit përkrahën miratimin në parim të Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Pasi që nuk kishte vërejtje dhe propozime, zv. kryesuesja e dytë e komisionit, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë në parim Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale.

#### **6. Shqyrtimi Projektligjit për Gazin Natyror me raportin e komisionit funksional Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente**

**Kosara Nikolić**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve konkrete, zv. kryesuesja e dytë e komisionit, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

#### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Gazin Natyror dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

**II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**7. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente**

**Kosara Nikolić**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për Projektligji dhe amendament e komisionit funksional lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

**Safete Hadërgjonaj**, si anëtare e komisionit funksional që ka propozuar amendamentet, theksoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime shtesë buxhetore.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve konkrete, zv. kryesuesja e dytë e komisionit, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

**REKOMANDIM**

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për standardizimin dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**8. Të Ndryshme**

**Kryesuesi**, njoftoi anëtarët e komisionit për kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Përvetësimin e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtimi dhe Zhvillim. Njëkohësisht i njoftoi edhe për dorëzimin në Kuvend të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Anëtarët e komisionit unanimisht u pajtuan që këto dy pika të jenë objekt shqyrtimi në mbledhjen e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Gani KOCI**